



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 38, datë 05.10.2023

PËR

MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar, (*ligji 8102*), të nenit 9 të Vendimit nr.539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e Metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve Ujësjetellës Kanalizime”, (*VKM nr.539*) “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (*Rregullore*) si dhe në vijim të analizës së prezantuar nga DSHM për nevojën e rritjes së të ardhurave nga pagesat rregullatore për mbështetje financiare të ERRU-së, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të aplikohet koeficienti 0.77 % mbi të ardhurat e vitit paraardhës për llogaritjen e pagesës rregullatore për të gjithë operatorët me efekte nga data 01.01.2024.
2. Ndjekin dhe përgjigjen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Teknike Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 485, datë 14.10.2022 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Ndriçim Shani**